



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 112/2 prot.

Tiranë, më 17.02.2020

VENDIM

Nr.22, datë 17.02.2020

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 125, DATË 08.11.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA VLORE**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 125, datë 08.11.2019, “Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Vlorë të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki”.

KONSTATOVA SE:

Me Urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Vlorë.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Vlorë, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 125, datë 08.11.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 2 muajsh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në detyrat e lëna për institucionin e mbikëqyrur, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, konstatohet se, situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht në pikën 1 të tij, është lënë detyrë, për njësinë përgjegjëse, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të përfshijë në kategorinë e nëpunësve civilë 3 pozicionet e punës “*Specialist i QKB-së*”, pranë Bashkisë Vlorë dhe në zbatim të nenit 67, të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të deklarojë statusin e punësimit për 2 punonjësit aktual në këtë pozicion pune.

Konstatohet se, institucioni i mbikëqyrur Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 980/1 prot., datë 20.01.2020, me objekt: “*Dërgim i veprimeve administrative në zbatim të Vendimit nr. 125, datë 08.11.2019*”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 112 prot., datë 23.01.2020, ka informuar këtë të fundit se, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për dy punonjësit në pozicionin “*Specialist të QKB*”, pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht:

- 1) Me aktin “*Për statusin e nëpunësit civil*”, me nr. 11269 prot., datë 19.12.2019, punonjësja ***** është deklaruar “*Nëpunëse civile*”, në pozicionin “*Specialist sporteli QKB*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Bashkia Vlorë.
- 2) Me aktin “*Për statusin e nëpunësit civil*”, me nr. 11270 prot., datë 19.12.2019, punonjësi ***** është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Specialist sporteli QKB*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Bashkia Vlorë.

Ndërsa një pozicionin mbetet i lirë dhe në vijim do të shpallet procedura për rekrutim.

Më tej, në pikën 2, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka lënë detyrë për njësinë përgjegjëse të Bashkisë Vlorë, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për ato pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në të cilat mungojnë, dhe të vijoje procesi i plotësimit të pozicioneve të lira, në zbatim të kërkesave të ligjit dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të paralajmërimit.

Sa i takon zbatimin të kësaj detyre, rezulton se, njësia përgjegjëse ka përfunduar hartimin e përshkrimeve të punës për pozicionet pjesë e shërbimit civil në të cilat mungonin.

Gjithashtu ka kryer procedura konkurimi për pozicionet e lira për vitin 2019 si dhe është në proces të procedurave për vitin 2020, sipas informacionit të dërguar me anë të shkresës nr.980/1 prot., datë 20.01.2020, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 112 prot., datë 23.01.2020.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 125, datë 08.11.2019, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Vlorë të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki”.*
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Vlorë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Paralajmërues të Komisionerit Nr. 125, datë 08.11.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Vlorë, Ministria e Brendshme si dhe Prefekti i Qarkut Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha